



**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
**УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA**

Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222  
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

## NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 136** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 05.11.2018 deri më 19.11.2018.

Tetovë, më 05.11.2018



**Zyra për çështje juridike**

Drejtuar:  
**Këshillit të Rektoratit të  
Universitetit të Tetovës**  
Tetovë

## REFERAT

**për zgjedhjen e një mësimitdhënësi për lëndët *E drejta ndërkombëtare publike dhe Të drejtat e njeriut (Kriminalistikë)* në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës**

Në bazë të Konkursit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimitdhënësvë në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, të datës 02.06.2018 të shpallur në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk dhe në gazetën ditore “Koha” në datë 04.06.2018, për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimitdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** për lëndët **E drejta ndërkombëtare publike dhe Të drejtat e njeriut (Kriminalistikë)** në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës. Me propozim të Këshillit mësimoro-shkencor të Fakultetit Juridik nr. **13-808/3** të datës 18.09.2018 dhe me vendim të Këshillit të Rektoratit nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ formohet **Komisioni Recenzues** në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Ylber Sela – kryetar**
- 2. Prof. Dr. Bekim Kadriu – anëtar**
- 3. Doc. Dr. Bujar Ahmedî – anëtar**

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur dhe në përputhje me nenet 121, 124, 125, 131 dhe 132 të Ligjit për Arsim të Lartë (Teksti i konsoliduar “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15 dhe 30/16), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Regulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve dhe asistent-doktorantëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

## RECENZION

Në konkursin e shpallur nga Universiteti i Tetovës në datë 02.06.2018 në web faqen, www.unite.edu.mk, dhe në gazetën ditore “Koha” për zgjedhjen e një mësimitdhënësi për lëndët: **1. E drejta ndërkombëtare publike** dhe **2. Të drejtat e njeriut (Kriminalistikë)** në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** në fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, u paraqitën kandidatët:

### **1. Dr. iur. Vlona Shehu**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja Dr. Vlona Shehu, ka lindur më 14.12.1983 në Strugë të Republikës së Maqedonisë. Shkollën fillore e përfunduar në shkollën fillore “Vëllezërit Milladinov” në Strugë. Shkollimin e mesëm e ka kryer në gjimnazin “Niko Nestor” drejtimi matematikonorror në Strugë, ku edhe është zgjedhur nxënësjja më e mirë e gjeneratës në vitin 2001/2002. Ka studiuar dhe diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Europës Juglindore me notë mesatare 9,4.

Studimet e magjistraturës i ka përfunduar po në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Europës Juglindore, drejtimi E Drejta e BE-së dhe Integrimet me notë mesatare 8,9. Në datë 10.05.2010 e ka mbrojtur temën e magjistraturës me titull “*Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë së BE-së ndaj Republikës së Kosovës*” me udhëheqës Prof. Dr. Enver Hasanin ku fiton titullin Magjistër i Shkencave Juridike.

Në vitin 2007 kandidatja punësohet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës në thirrjen asistent i ri. Në datë 21.02.2013 kandidatja fiton titullin bashkëpunëtor në thirrjen asistent po në fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

Kandidatja Vlona Shehu, në vitin 2011 i regjistron studimet e doktoraturës, në Fakultetin Juridik të Universitetit Karl Franzens të Gracit në Austri në drejtimin ndërkombëtar. Dizertacionin e doktoraturës kandidatja e mbron ne 13 Prill, 2018, para komisionit për mbrojtjen e doktoraturës në përbërje:

1. Univ. -Prof. Mag. Dr.iur Wolfgang Benedek (mentor)
2. ao.Univ. -Prof. Dr. Hubert Isak (ko-mentor)
3. ao.Univ. -Prof. Dr. Markus Steppan (anetar)

Tema e dizertacionit “*Monitorimi i të drejtave të njeriut dhe të pakicave në procesin e anëtarësimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor (rasti i Maqedonisë)*”. Kandidatja e mbrojti me sukses temën e doktoraturës dhe fitoi titullin Doktor i Shkencave Juridike (*Doktor Iuris – Dr. iur.*).

#### **Kandidatja Dr. iur. Vlona Shehu në konkurs në afat kohor dorëzoi këto dokumente:**

- Fletën e aplikimit për konkursin e hapur
- Diplomën origjinale të doktoraturës (kopje të noterizuar);
- Diplomën e nostrifikuar të doktoraturës (kopje të noterizuar);
- Diplomën e studimeve të magjistraturës (kopje të noterizuar);
- Diplomën e studimeve deridiplomike (kopje të noterizuar);
- Çertifikatën e notave të studimeve të magjistraturës (kopje origjinale);
- Çertifikatën e notave të studimeve deridiplomike (kopje origjinale);
- Rezultatet e testit TOEFL për njohje të gjuhës angleze (82 pikë);
- Biografinë e shkurtër që dëshmon aktivitetet e vazhdueshme shkencore dhe profesionale;
- Çertifikatën nga libri amzë i të lindurve;
- Çertifikatën e shtetësisë;
- Listë të punimeve shkencore;
- Çertifikatat nga konferencat shkencore bashkë me kopje të punimeve relevante;

#### **Përvoja universitare**

Përvoja universitare e kandidatës Dr. iur. Vlona Shehu tregon një kontinuitet nga viti 2007. Në bazë të vendimit me numër 02-422/2 të datës 07.05.2007, zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore Asistent i ri në fushën e së drejtës.

Në datën 21.02.2013 kandidatja zgjidhet bashkëpunëtor në thirrjen Asistent në bazë të vendimit me numër 04-1945/01 të datës 04.04.2013.

Pas hapjes të studimeve të disperzuara në Shkup dhe Kërçovë nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Tetovës, kandidatja ka qënë e angazhuar në studimet e disperzuara në Shkup për shtatë vite me rradhë në

lëndët: **E drejta ndërkombëtare publike, E drejta e Unionit European dhe Kërçovë në lëndët mësimore: E drejta e Unionit European, Organizatat Ndërkombëtare, Historia e BE-së.**

#### **Aktivite profesionale dhe shkencore**

Kandidatja ka qënë anëtare e këshillit organizues në konferencën e dytë ndërkombëtare “Universality, Globalization and the Rule of Law” të mbajtur në Universitetin e Tetovës.

Në bazë të vendimit me numër 13-237/1 të datës 27.02.2017 kandidatja emërohet koordinatore për projekte nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës, detyrë të cilën vazhdon ta ushtrojë.

Kandidatja Dr. iur. Vlona Shehu ka marë pjesë në punëtorinë interdisciplinare të doktoraturës “Human Rights, Democracy, Diversity and Gender” e organizuar nga Qendra Europiane për Trajnim dhe Hulumtim në të Drejtat e Njeriut dhe Demokracisë nga Universiteti Karl Franzens në Grac të Austrisë (UNI-ET) në bashkëpunim me qendrën ndëruniversitare Europiane (EIUC) në Prill të 2014. Atje kandidatja ka prezantuar punimin me temë: “Monitorimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut në Ballkanin Perëndimor: Korniza Institucionale dhe Ligjore për Maqedoninë”.

Në Prill të vitit 2016 kandidatja ka prezantuar në konferencën shkencore “Tradition of the Law and the Law in Transition: Social, Political and Normative Processes in a Comparative Perspective”, Fakulteti juridik, Tiranë.

Kandidatja është gjithashtu anëtare e komisionit për evaluim të procesit mësimor pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës.

Kandidatja Dr. iur. Vlona Shehu ka botuar punim shkencor me faktor ndikimi në Kongresin e IV Botëror të të Drejtave të Njeriut, Drejtësisë dhe Studimeve të së Drejtës të mbajtur në vitin 2017 në Shën Petersburg të Rusisë.

#### **Listë e publikimeve shkencore**

Vlona Pollozhani Shehu; Limited improvements made as a result of the Accession Process regarding Human Rights in Macedonia; 4th World Congress on Human Rights, Justice and Legal Studies (WCHJL2017), Published by ISCDBU Inc. 0-557-72797-9 :ISBN, St. Petersburg, Russia.

Vlona Pollozhani Shehu; EU Instruments for monitoring human and minority rights in the Accession Process of Macedonia; Konrad-Adenauer-Stiftung, University of Tirana, ISBN: 978-9928-174-23-9, 2016, Tirana, Albania.

Vlona Pollozhani Shehu; Framework Convention on National Minorities, as an Instrument for Monitoring Human Rights, Justicia, ISSN 1857-8454, 2018, Tetova, Macedonia.

Vlona Pollozhani Shehu; The role of Regional Actors in monitoring Human Rights (Possible duplication of competences), Justicia, vol.5, No.8, ISSN 1857-8454, Tetova 2017.

Vlona Pollozhani Shehu; Implications of the Accession Process of EU regarding Human Rights in Macedonia, Justicia, vol.4, No.5 ISSN 1857-8454, Tetova, 2016.

Vlona Pollozhani; The consistency of relations between Republic of Kosovo and the European Union in the pre-accession process; Scientific and Professional Journal - Ulpianus nr. 1/2011; Tetovo; Macedonia

Vlona Pollozhani; Monitoring violations of Human Rights in Western Balkan countries: Existing Legal and Institutional Framework for Macedonia; UNI-ETC, Graz, EIUC, Venice, 2014.

## **2. Dr. Havsa Musliu**

Në bazë të dokumentacionit të dërguar kandidatja Havsa Musliu ka lindur në 01.04.1986 ne fsh. Çajle të Gostivarit. Shkollimin e mesëm e kreu në shkollën medicinale “Pançe Popovski” në Gostivar. Më pas studimet deridiplomike në Fakultetin juridik të Universitetit të Evropës Juglindore. Studimet pasdiplomike te masterit ne drejtimin penal i përfundon poashtu në Universitetin e Evropës Juglindore me temë: “Deklarimi i të pandehurit si provë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë”. Studimet e doktoraturës kandidatja i përfundon në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, poashtu në drejtimin e së drejtës penale dhe mbron temën me titull: “E drejta e heshtjes në procedurën penale”.

Kandidatja Havsa Musliu dërgoi këto dokumente në konkurs:

- CV (biografi e shkurtër e aktiviteteve shkencore dhe përvojës së punës)
- Çertifikatë të lindjes (të noterizuar)
- Çertifikatë të shtetësisë
- Çertifikatë të notave në studimet e doktoraturës
- Vendim nga komisioni i mbrojtjes së doktoraturës për mbrotjen e temës
- Diploma e studimeve të magjistraturës (e noterizuar)
- Diploma e studimeve deridiplomike (e noterizuar)
- Listë e publikimeve shkencore bashke kopje të të njejtave
- Punimi i doktoraturës
- Çertifikatë për përfundimin e kurseve në gjuhën angleze

### **Përvoja e punës:**

Në vitin 2013 kandidatja ka punuar si zëvendës sekretare në departamentin për çështje juridike në Komunën e Gostivarit. Po në të njëjtin vit për dy muaj ka punuar si mësimdhënëse në shkollën e mesme ekonomike “Gostivar” në Gostivar. Nga viti 2015 dhe në vazhdim punon si mësimdhënëse në shkollën e mesme ekonomike “Gostivar”. Kandidatja paralelisht punon si e vetëpunësuar në zyrën e avokatisë për çështje penale. Në vitin 2014 ka marrë certifikatë për dhënien e provimit të jurisprudencës në Gjykatën e Apelit në Shkup.

### **VLERËSIM DHE PROPOZIM**

Në bazë të analizës të aktiviteteve të lartpërmendura, Komisioni Recenzues, vlerëson se kandidatja Vlona Shehu i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** duke u mbështetur edhe në përvojën e vazhdueshme profesionale akademike dhe pedagogjike të kandidatit.

Duke marrë parasysh aktivitetin gjithëpërfshirës të kandidates nga sfera e së Drejtës si dhe kontinuitetin mbi dhjetë vjeçar në studimet për fushën ndërkombëtare gjatë marrjes të të gjithë gradave shkencore dhe mësimore, pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare, projekte hulumtuese, të arriturat shkencore të prezantuara në disertacionin e doktoraturës, punimin e magistraturës, punimet shkencore dhe profesionale të publikuara, kompatibilitetin profesional me lëndët e shpallura në konkurs, komisioni vlerëson se **Dr. iur. Vlona Shehu**, i plotëson të gjitha kushtet për thirrjen mësimore-shkencore **Docent** sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Arsim të Lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë ti propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës që **Dr. iur. Vlona Shehu** të zgjidhet **Docent** për lëndët: *E drejta ndërkombëtare publike* dhe *Të drejtat e njeriut (Kriminalistikë)* në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës.

Kandidatja e dytë, **Dr. Havsa Musliu**, nuk ka dëshmi të kontinuitetit akademik. Gjithashtu, kandidates Dr. Havsa Musliu i mungon eksperiencia dhe shkollimi adekuat në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut. Fusha e studimit të kandidates është nga drejtimi Penal. Nga dokumentet e dorëzuara, kandidates Dr. Havsa Musliu i mungojnë diploma e studimeve të doktoraturës ose çertifikata që dëshmon kryerjen e studimeve të doktoraturës. Nga vërtetimi i dorëzuar për njohje të gjuhës angleze, kandidatja ka dorëzuar çertifikatë të përfundimit të kursit për gjuhën angleze, por mungon dëshmia e nivelit (B2) nga autoritet ndërkombëtarisht i pranuar si TOEFL, IELTS, ALTE ose të ngjashëm. Gjithashtu kandidatja nuk ka dorëzuar fletë aplikimin e plotësuar për këtë konkurs.

SHTOJCE PER RAPORTIN PER ZGJEDHJEN NE THIRRJEN MESIMORE-SHKENCORE DHE  
MESIMORE PROFESIONALE

Kandidati: Dr.sc. Havsa Musliu

Nr. rendor	Veprimtaria Shkenore-hulumtuese	Pike t
1.	Declaration of the Defendant as Proof of Criminal Proceedings in the Republic of Macedonia, Scientific and Professional Legal Magazine "ULPIANUS" in the second issue of the magazine, 2012, Skopje (Deklarimi i të pandchurit si prove ç procedure penale në Republikën e Maqedonisë, Revista Shkenore dhe Profesionale Juridike "ULPIANUS" në numrin e dyte të revistës, 2012).	2
2.	The principle of presumption of innocence in criminal proceedings in the Republic of Macedonia, Journal of Social Sciences "VIZIONE" in the nineteen (19) issue of the magazine in 2013, Skopje (Parimi i prezumimit te pafajësisë në procedurë penale në Republikën e Maqedonisë, Revista e Shkencave Shoqerore "VIZIONE" në numrin e nentëmbëdhjete (19) te revistes, në vitin 2013).	3
3.	Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale (The rights of the defendant in criminal procedure). In Knowledge International Journal Vol. 20 with Global Impact Factor 1.322 (2016), promoted in Bansko Bulgaria, 17.12.2017	6
4.	E drejta në gjykim te drejte dhe ne kohe te arsyeshme (The right to a fair trial and at a reasonable time). In Knowledge International Journal Vol. 20 with Global Impact Factor 1.322 (2016), promoted in Bansko Bulgaria, 17.12.2017	3
5.	Polygraph use(Polygraph testing). 4th International Scientific Conference of the Faculty of Law titled: "Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process". 17-18 November 2017, Tetova.	6
6.	Confession and denial of the defendant as evidence in criminal proceeding in Republic of Macedonia (Pohimi dhe mohimi I të pandehurit si provë ne procedure penale ne Republikën e Magedonise). 2nd International Scientific Conference on Innovative Marketing "Communication and digital marketing management. February 23 & 24, 2018. Marketing Department, Business Faculty, University "Aleksandër Moisiu", Durres Albania	3
7.	Illgal evidence and legal consequences of their use (Provat e paligishme dhe pasojat juridike te perdorimit te tyre). International scientific conference, presented at ICEICH 2018, held on 15-16 February, 2018 in Prishtina.	2
	Totali	25

Kandidati: Dr.iur. Vlona Shehu  
 Institucioni: Universiteti i Tetoves, Fakulteti Juridik  
 Programi studimor: Studime te Drejtesise

VEPRIMTARIA MESIMORE SHKENCORE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Piket
<b>I</b>	<b>Mbajtja e ligjeratave</b>	
I.1	E drejta nderkombetare publike (2+2, Shkup (drejtimi Shkenca Politike, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
I.2	Studime Evropiane (2+2, Tetove, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
I.3	Drejtesia dhe punet e brendshme ne BE, (2, 3 semestra, Tetove)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 3.6$
I.4	E drejta e Bashkimit Evropian (2+1, Kercove, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
I.5	Organizatrat nderkombetare (2+1, Kercove, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
I.6	Historia e BE (2+2, Kercove, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
I.7	Politika sociale (2+2, Shkup, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$
I.8	Politika e jashtme e SHBA-se, (2+2, 3 semestra)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 3.6$
I.9	Marrëdhëniet me publikun (2, Tetovë, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
<b>II.</b>	<b>Mbajtja e ushtrimeve</b>	
II.1	E drejta nderkombetare publike (2, Tetove, 4 semestra)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
II.2	E drejta nderkombetare publike (2, Shkup, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
II.3	E drejta e Bashkimit Evropian (2, Tetove, 4 semestra)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 3.6$
II.4	E drejta e Bashkimit Evropian (2, Shkup, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
II.5	Politika e perbashket e jashtme dhe e sigurise se BE (2. Tetove, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
II.6	Te drejtat e njeriut (2+1, Tetove, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
II.7	Studime Evropiane (2+2, Tetovë, 2 Semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
II.8	Organizatrat nderkombetare (2+1, Kercove, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
II.9	Historia e BE (2+2, Kercove, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
II.10	Politika sociale (2+2, Shkup, 1 semester)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
II.11	Politika e jashtme e SHBA-se, (2+2, 3 semestra)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.03 = 2.7$
<b>III</b>	<b>Mbajtja e konsultimeve</b>	
III.1	E drejta nderkombetare publike (2+2, Shkup (drejtimi Shkenca Politike, 2 semestra)	$50 \times 2 \times 0.002 = 0.16$
III.2	Studime Evropiane (2+2, Tetove, 2 semestra)	$80 \times 2 \times 0.002 = 0.32$
III.3	Drejtesia dhe punet e brendshme ne BE, (2, 3 semestra, Tetove)	$50 \times 2 \times 0.002 = 0.16$
III.4	E drejta e Bashkimit Evropian (2+1, Kercove, 1 semester)	$50 \times 2 \times 0.002 = 0.16$
III.5	Organizatrat nderkombetare (2+1, Kercove, 1 semester)	$50 \times 2 \times 0.002 = 0.16$
III.6	Historia e BE (2+2, Kercove, 1 semester)	$50 \times 2 \times 0.002 = 0.16$
III.7	Politika sociale (2+2, Shkup, 1 semester)	$50 \times 2 \times 0.002 = 0.16$
III.8	Politika e jashtme e SHBA-se, 2+2, 3 semestra)	$80 \times 2 \times 0.002 = 0.32$
	<b>Totali</b>	<b>40.6</b>



VEPRIMTARIA SHKENCORE- HULUMTUESE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pike t
I	Artikuj me rezultate shkencore origjinale te publikuara ne Reviste shkencore / profesionale me bord redaktues nderkombetar	
I.1	Vlona Pollozhani Shehu; Limited improvements made as a result of the Accession Process regarding Human Rights in Macedonia; 4th World Congress on Human Rights, Justice and Legal Studies (WCHJL2017), Published by ISCDBU Inc. 0-557-72797-9 :ISBN, St. Petersburg, Russia.	10
I.2	Vlona Pollozhani Shehu; EU Instruments for monitoring human and minority rights in the Accession Process of Macedonia; Konrad-Adenauer-Stiftung, University of Tirana, ISBN: 978-9928-174-23-9, 2016, Tirana, Albania.	6
I.3	Vlona Pollozhani Shehu; Framework Convention on National Minorities, as an Instrument for Monitoring Human Rights, Justicia, ISSN 1857-8454, 2018, Tetova, Macedonia.	6
I.4	Vlona Pollozhani Shehu; The role of Regional Actors in monitoring Human Rights (Possible duplication of competences), Justicia, vol.5, No.8, ISSN 1857-8454, Tetova 2017.	6
I.5	Vlona Pollozhani Shehu; Implications of the Accession Process of EU regarding Human Rights in Macedonia, Justicia, vol.4, No.5 ISSN 1857-8454, Tetova, 2016.	6
I.6	Vlona Pollozhani; The consistency of relations between Republic of Kosovo and the European Union in the pre-accession process; Scientific and Professional Journal - Ulpianus nr. 1/2011; Tetovo; Macedonia	4
II	<b>Pjesëmarrje në punëtori interdisciplinare të doktoraturës</b>	
II.1	Vlona Pollozhani; Monitoring violations of Human Rights in Western Balkan countries: Existing Legal and Institutional Framework for Macedonia; UNI-ETC, Graz, EIUC, Venice, 2014.	5
II.2	Vlona Pollozhani; The role of EU actors in monitoring Human Rights; UNI-ETC, Gamliz, Austria, 2012.	5
III	Ligjerues i ftuar nga Universiteti	
III.1	Ligjerata me teme “Maqedonia ne procesin e anetaresimit, analize e raporteve te progresit”. Me Fakultetin Juridik te Universitetit te Gracit.	2
	<b>Totali</b>	<b>50</b>

VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
------------	--------------------	-------

1.	Anëtare e Komisionit për evaluimin e procesit mësimor me mandat 4 vjeçar	1
2.	Koordinatorë për projekte në Fakultetin juridik	2
3.	Anëtare e komitetit organizativ të Konferencës së dytë ndërkombëtare “Universality, Globalization and the Rule of Law”, 13-14 November, 2015, Tetovë.	1
4.	Pjesëmarrës në konferencën shkencore “Tradition of the Law and the Law in Transition: Social, Political and Normative Processes in a Comparative Perspective”, Fakulteti juridik, Tiranë.	2
5.	Pjesëmarrës në Konferencën shkencore “The Law and Challenges of the Euro-Atlantic Processes”, November 2016, Tetovë.	2
6.	Pjesëmarrës në Konferencën shkencore “Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process”, November 2017.	2
	<b>Totali</b>	<b>10</b>

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore shkencore	40.60
2.	Veprimtaria shkencore hulumtuese	50.00
3.	Veprimtaria me interes më të gjërë	10.00
	<b>Totali</b>	<b>100.60</b>

#### **KOMISIONI RECENZUES:**

Prof. Dr. Ylber Sela

---

Prof. Dr. Bekim Kadriu

---

Doc. Dr. Bujar Ahmedi

---